



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 5080/4 Prot.

Pogradec, më 08/12 .2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

" Për heqjen nga kontabiliteti, dhe lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, të vendstrehimit 48, që i korespondon pronës me numur 78 "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagjen nr 1 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec"

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 10(Dhjetë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____/____/2024

PËR

Heqjen nga kontabiliteti, dhe lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, të vendstrehimit 48, që i korespondon pronës me numur 78 “Vëndstrehim” me vendodhje në Lagjen nr 1 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.1240, datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", VKM nr 280 datë 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse” të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 3777/2 date 01/07/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë heqjen nga inventari ekonomik i Ndërmarrjes së Mirembajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike të vendstrehimit nr 48 qe i korespondon pronës me nr 78 me emërtimin “Vëndstrehim” me vëndodhje në Lagjia nr 1 Pogradec, mbi pasurine 5/251, Zona kadastrale 8581 sipërfaqja 85 m2, që me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar në Pronësi të Bashkisë Pogradec.
2. Ngarkohet Ndermarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Sektori i verifikimit titujve te pronesise dhe shpronesimeve, dhe sektori Aseteve pranë Drejtorise së Financave që në zbatim të ligjit nr 10296/2010 “Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të kryejne veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditesimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Angjesisë Shtetërore të Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec, të vendstrehimit nr 48 qe i perket pronës me nr 78 me emërtimin “Vëndstrehim” me vendodhje në lagjen nr 1 Pogradec.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, DHE ADMINISTRIMIT TOKËS BUJQËSORE NË
NJËSITË ADMINISTRATIVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE TE PRONËSISË DHE SHPRONËSIMEVE

Nr. 5080/Prot.

Pogradec, më 18.12.2024

RELACION

PËR

Heqjen nga kontabiliteti dhe lista perfundimtare të pronave të paluajtshme, të "Vendstrehimit" nr 48, me nr 78 ne listen e inventarit, vendodhje ne Lagjen nr 1 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar ne pronesi te Bashkise Pogradec.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr.1240, datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirembajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, shkrese se Ministrise se Mbrojtjes nr 3777/2 prot date 01/07/2024, po ju paraqesim kete projektvendim i cili ka per qellim sistemimin ne kontabilitet, si dhe fshirjen nga lista perfundimtare te pronave te paluajtshme qe me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar ne Pronesi te Bashkise Pogradec, te prones me nr 78 te listes me emertimin "Vendstrehimi nr 48" me vendodhje ne lagjen nr 1 Pogradec, me vendodhje ne pasurine 5/251 Zona kadastrale 8581 me siperfaqe 85 m2.

Admnsitrata e Bashkise per pergatitjen e ketij materiali eshte inicuar nga nje kerkese e nje banori te lagjes nr 1 te cilet i jane drejtuar me kerkese Bashkise Pogradec mbasi Vendstrehimi ka dale nga funksionet e tij.

Bashkia ngriti grupin e punes dhe duke u bazuar ne VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirembajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, ju drejtua me shkresn nr 2263 date 17.05.2024 Ministrise se Mbrojtjes ku ka kerkuar miratimin per nxjerrjen jashte perdorimit te ketij vendstrehimi.

Ministria e Mbrojtjes me shkresen nr 3777/1 date 01/07/2024 ka miratuar kerkesen tone per nxjerrjen jashte perdorimit te objektit "Vendstrehim nr 48" me nr 78 sipas VKM nr 1240 date 10.09.2008 me vendodhje ne Lagjen nr 1 Pogradec, prone mbi pasurine 2/251 me siperfaqe 85 m2.

Te nderuar Këshillatër,

Miratimi i ketij projektvendimi zgjidh keto probleme:

-Sistemon Kontabilitetin e Ndermarrjes se Mirembajtjes se Infrastruukturave dhe Puneve Publike, per diferencen e krijuar nga nxjerrja jashte perdorimit te Objektit "vendstrehim".

-Fshirjen nga lista perfundimtare te pronave te palusjteshme te prones me nr 78 te listes me emrtimin "Vendstrehimi nr 48" me vendodhje lagjia nr 1 Pogradec, qe me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar ne pronesi te Bashkise Pogradec.



Bashkangjitur relacionit aktet e meposhteme:

- VKM nr 1240 date 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës".
- Kërkesa nr 2263 prot e dates 17/05/2024 derguar ministrise Mbrojtjes .
- Procesverbali i specialisteve te sektorit perkates per gjendjen e vendstrehimit.
- Pergjigjja e Ministrise se Mbrojtjes nr prot 3777/2 date 01.07.2024.

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju Faleminderit !


Konceptoi: Herolind MANELLARI

Spartak KUQO

Konfirmoi: Nexhmi TORRA

Miratoi: Ditan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



POGRADEC
NR. 2263/ PROT
03.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

A. M. B. Tokes

Nr. 3777/prot.
2

Tiranë, më 1.7.2024



Lënda: Kthim përgjigje shkresës me nr. 2263 prot., datë 17.05.2024.

BASHKISË POGRADEC

Pogradec.

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 2263 prot., datë 17.05.2024, nëpërmjet së cilës kërkohet nga Ministria e Mbrojtjes miratimi për nxjerrjen jashtë përdorimit të vendstrehimit nr. 48, i cili shtrihet në pasurinë 5/251, zona kadastrale 8581, që ndodhet të listën e inventarit të bashkisë sipas VKM nr.1240, datë 10.09.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", sqarojmë dhe shprehemi sa më poshtë:

Referuar informacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës suaj, si dhe informacionit të dërguar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, rezulton se nga verifikimi i kryer në vend nga grupi i verifikimit të SHPFA-së, të objektit vendstrehim, me vendndodhje në pasurinë nr. 5/251, ZK 8581, bashkia Pogradec, ku rezulton se objekti i sipërcituar nuk bën pjesë në listën e inventarit të pronave në përgjegjësi administrimi të MM-së, miratuar me VKM nr. 515, datë 18.07.2003, të ndryshuar.

Bazuar në VKM nr.550, datë 14.08.2001, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 3, datë 18.07.2002, të ish-Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore nga njësitë e qeverisjes vendore", objektet vendstrehim janë në inventar dhe në administrim të pushtetit vendor (bashkive).

Nga verifikimi në vend i bërë nga grupi i verifikimit të SHPFA-së, së bashku me përfaqësues të bashkisë Pogradec, është konstatuar se objekti vendstrehim nr. 48, me vendndodhje në pasurinë nr. 5/251, ZK 8581, bashkia Pogradec, nuk ekzistonte pasi në vendndodhjen e tij ishin ndërtuar rrugë që shërbenin për banorët e kësaj zone (bashkëlidhur foto).

Për sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes bazuar në prononcimin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, shprehet se nuk mund të japë miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve të cilat nuk ekzistojnë.

Faleminderit!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, DHE ADMINISTRIMIT TOKËS BUJQËSORE NË
NJËSITË ADMINISTRATIVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE TE PRONËSISË DHE SHPRONËSIMEVE

Nr. 2273 Prot.

Pogradec, më 17.03.2024

Lënda : Kërkesë për miratim.

**MINISTRIA E MBROJTJES
TIRANË**

**SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA
TIRANË**

Në bazë të ligjit nr 139/2015 datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirembajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, dhe kërkesës së disa banoreve të lagjes nr 1 kërkojmë nga ana juaj:

Miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të vendstrehimit nr 48 që ndodhet në listen e Inventarit të Bashkisë me nr 78 sipas VKM nr 1240 datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", shtrihet në pasurine 5/251 zona kadastrale 8581 duke qënë se ky vendstrehim sipas aktit verifikimit bashkangjitur është shumë i dëmtuar dhe jashtë funksionit.

Bashkia Pogradec do t'ju vëjë në dispozicion çdo dokumentacion dhe informacion që ju do t'ju nevojitet për këtë proces.

Bashkangjitur korespondenca.

1- Akt Verifikimi.


2- Planimetrine e vendstrehimit.

3- VKM nr 1240 me fletën e inventarit përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**

**ME URDHËR DHE MË DELEGIM
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
DRITAN BABASULLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE CESHTJEVE JURIDIKE
SEKTORI I MONITORIMIT KONTRATAVE

AKT - VERIFIKIMI

" Mbi gjendjen ekzistuese te objektit vendstrehim "


Vendstrehimi : Nr. 48

Inventar : Nr. 78

Nr. Pasurise : 5 / 251

Siperfaqe Gjithsej : 276 m2 Siperfaqe e objektit : 85 m2

Nga verifikimi ne vend i objektit vendstrehimi Nr. 48, ju paraqesim kete foto dhe shpjegues.



Vendodhja : Ky vendstrehim ndodhet tek Villazeria Sulce, tek furgonat e Geshtenjasit.

Raport teknik : Ky vendstrehim nuk ekziston . Eshte shembur dhe mbi te eshte ndertuar nje rruge lagje.

Punoi :

Ing. Spartak Kuqo
Spec. Herolind Malellari

Pergjegjesi i Sektorit :

Nexhmi Torra



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1240, datë 10.9.2008

P Ë R


**MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, OË TRANSFEROHEN,
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË POGRADEC, TË
QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 297 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë).



2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Pogradecit për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

Sali Berisha
SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

Bujar Nishani
BUJAR NISHANI


Bashkia Pogradec



| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|----------------------|
| 106,107 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi |
| 4-5,7-12,16 | Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor. | Në pronësi |
| 158-170 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 173 (vetëm ambientet e shërbimit parësor), 175 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shërbimi parësor. | Në pronësi |
| 1-3,6,13-15,17 | Prona që përdoren në fushën e sportit kulturës | Në pronësi |
| 19-90, | Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile. | Në pronësi |
| 91-105,110,113, | Infrastruktura (rrugë vendore,lulishte)dhe shërbime publike. | Në pronësi |
| 115-116, | Varrezat publike. | Në pronësi |
| 111 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim |
| 18 | Prona që përdoren në fushën sociale | Në pronësi |
| 114 | Rijeti i ndriçimit publik. | Në pronësi |
| 112 | Transferohen vetëm ledhe mezhda, shkëmbore, gurishtore,toka te pafrytshme. | Në pronësi |
| 121-125,127,138-143,149,151, | Zyra te partive politike shoqatave ose zyra te tjera qe ndodhen ne ndertesen e bashkise. | Në pronësi |
| Z.Kadastrale 8582, pasurite nr.1/174,1/176,1/177,1/178, | Truall | Nuk transferohen |

MINISTRI

Bujar NISHANI



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror:


Bashkia / Komuna : Pogradec.

Fusha e perdorimit te Prones: Strehim & Mbrojtje civile

Identifikoi: **Altin Zhubro**

Supervizori: **Alqi Mema**

Aprovi: **Mangalina Cane**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, yzula)



B

A

| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale Sa Nderfese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te vecanta) |
|-----------|----------------------------------|--------------|----------------|--|---------------------------|----------------------------------|---------------------------------------|---|--|--|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 19 | | 3 | Vendstrehim | Vendstrehim Nr. 1 Kodra Verdove Bashkia Pogradec | 58 | 7 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | Dhene me qera |
| 20 | | | Vendstrehim | Vendstrehim Nr. 2 Kampi i Pionereve Bashkia Pogradec | 208 | | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | |
| 21 | | | Vendstrehim | Vendstrehim Nr. 3 Stadiumi i Futbollit Bashkia Pogradec | 174 | | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | |
| 22 | | | Vendstrehim | Vendstrehim Nr. 4 Tek baneza e Kopi Lekes Bashkia Pogradec | 131 | | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | Dhene me qera |
| 23 | | | Vendstrehim | Vendstrehim Nr. 5 Tek baneza Nr. 49 Bashkia Pogradec | 101 | | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | |



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|----|-------------|---|--|-----|-----------------|---------|---------|---|---------------|---------------|
| 73 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 14 Tek Kalaja Bashkia Pogradec. | 377 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | | |
| 74 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 15 Tek Kalaja Bashkia Pogradec | 377 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | | |
| 75 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 23 Tek Spitali Bashkia Pogradec | 118 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | | |
| 76 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 46 Tek Çerdhja Nr. 3 Bashkia Pogradec | 112 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | | |
| 77 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 47 Tek M. Kreste Bashkia Pogradec | 84 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | Dhene me qera | |
| 78 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 48 Tek "Sulçet" Bashkia Pogradec | 85 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | | |
| 79 | Vendstrehim | | Vendstrehim Nr. 49 Tek banesa Nr. 177 Bashkia Pogradec | 56 | Mbrojtje civile | Bashkia | Bashkia | | | Dhene me qera |

